

Nr. 31 Dt. 27.04.2018
HQ 1

RAPORTI I PAJTUESHMËRISË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES 2017

Prishtinë
Prill 2018



Historiku i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Deri në vitin 2013 sektori i energjisë në Republikën e Kosovës ka qenë i organizuar vertikalisht. Kjo mënyrë e organizimit është udhëhequr nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe nga Korporata Energjetikë e Kosovës (KEK), e cila ka qenë përgjegjëse për gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore.

Me datë 8 Maj të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka mundësuar privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE).

Partneriteti Çalik-Limak formuan kompaninë “Çalik-Limak Energy sh.a” e cila fitojë të drejtën e licencës për OSSH-së dhe FPEE. Partneriteti Çalik-Limak fillojë të operojë nën titullin “Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS)” me datë 8 Maj 2013.

Në vitin 2014 kanë filluar aktivitetet në lidhje me shthurjen ligjore dhe funksionale të kompanisë. Në fund të vitit 2014 në bazë të kërkesave ligjore, detyrimeve të marrëveshjes së privatizimit dhe me udhëzimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është realizuar me sukses shthurja funksionale dhe ligjore e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

Sthurja ligjore rezultojë në formimin e kompanisë të furnizimit publik me energji elektrike “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESCO) nga ana e kompanisë amë Kosova Çalik-Limak Energy sh.a Ndarja e funksioneve ndërmjet KEDS dhe KESCO u bë duke respektuar kushtet e parapara në licencat reciproke dhe planit të veprimit të shthurjes ligjore.

ZRRE-ja me vendimin numër V_670_2014 ka lejuar transferimin e licencës së furnizuesit publik të energjisë elektrike nga KEDS te kompania e re KESCO. KESCO ka filluar të operojë në bazë të licencës së furnizuesit publik të energjisë elektrike nga data 1 Janar 2015. KEDS ka transferuar në KESCO të gjithë pasuritë, kontratat, punonjësit dhe detyrimet dhe të drejtat në lidhje me funksionet e FPEE.



Trajtimi i shërbimeve të përbashkëta për të dy kompanitë e licencuara është paraparë në planin e veprimit të shthurjes ligjore që të themelohen si njësi administrative në kuadër të OSSH-së dhe të kryejnë shërbime edhe për FPEE-në, në baza kontraktuale. Trajtimi i shërbimeve të përbashkëta është lejuar nga ZRRE-ja me vendimin numër V_619_2014. Vlen të theksohet se vendimi i ZRRE-së ka bërë të mundur efikasitetin dhe ka rritur produktivitetin e shërbimeve të përbashkëta si financat, IT, çështjet ligjore dhe ka përmirësuar kostot e këtyre shërbimeve të cilat dyfishoheshin në rast të kundërt në barrë të konsumatorit fundor.

Qendra e Thirrjeve është transferuar në KESCO dhe vazhdon të jetë funksion i saj.

Nga data 01 Janar 2015 deri me date 13 Prill 2017, KEDS ka mbajtur licencën për OSSH me numër ZRRE/Li/Tr_06/12. Licenca e OSSH-së është harmonizuar në bazë të ndryshimeve legjislativë dhe momentalisht KEDS mban licencën numër ZRRE/Li/Tr_06/17. Bazuar në kushtet e kësaj licence, dispozitave ligjore vendimin e ZRRE-së të datës 16 Korrik 2015 me Numër V_750_2015 për aprovimin e Programit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i licencuari ka përgatitur Raportin e Pajtushmërisë për vitin 2017.

Bazat Ligjore

Raporti i Pajtushmërisë për vitin 2017 është përgatitur në bazë të:

- Ligji Nr. 05/L-081 Për Energjinë
- Ligji Nr. 05/L - 085 Për Energjinë Elektrike
- Ligji Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin E Energjisë
- Licenca Nr. ZRRE/Li/Tr_06/17
- Legjislacionet Sekondare Relevante

Pikëpamja e Programit të Pajtushmërisë

Programi i Pajtushmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes është një program gjithëpërfshirës që i ndihmon kompanisë dhe punonjësit e saj të kryejnë operacione dhe aktivitete



në mënyrë etike me nivelin më të lartë të integritetit dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative.

Programi i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes i jep rendësi të veçantë masave të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese ndaj pjesëmarrëseve të sektorit të energjisë dhe palëve të interesuara.

Gjithashtu Programi i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes përkufizon rëndësinë e mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm afarist që OSSH-ja merr gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, informacion i cili mund të krijojë përparësi komerciale dhe të shtrembërojë konkurrencën nëse zbulohet në mënyrë diskriminuese.

Raporti i Pajtueshmërisë

-Zyrtari i Pajtueshmërisë

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka caktuar z. Ermal Koçi në detyrën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë me datë 31 Korrik 2015.

-Të Drejtat Dhe Përgjegjësitë e Punonjësve të OSSH-së

Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të OSSH-së janë parashtruar në Kodin e Etikës dhe Punës, Rregulloret e Brendshme dhe në formularët e përshkrimit të vendit të punës. OSSH-ja për punëtorët e rinj ka një program orientimi në mënyrë që punëtorët të njihen dhe familjarizohen me procedurat dhe rregulloret e kompanisë. Kompania mban takime specifike me qëllim trajnimi të punonjësve në lidhje me freskimin, modifikimin dhe njohjen me procedura të reja.



-Masat për Eliminimin e Sjelljeve Diskriminuuese

OSSH-ja nuk ka diskriminuar dhe ka marrë masat e nevojshme administrative për parandalimin e rrezikut jo sistematik të diskriminimit të pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike si gjeneratorët, furnizuesit dhe konsumatorët fundor.

Leximi i konsumatorëve fundor vazhdon të bëhet me Aparatet e Dorës për Lexim. Ky sistem i leximit dhe centralizimi i monitorimit të punës të punëtorëve të leximit parandalon gabimet njerëzore në lexim duke bërë të mundur leximin e saktë dhe efikas të konsumatorëve.

Konsumatorët industrial dhe ato komercial janë të pajisur me njehsorë inteligjentë që mundësojnë leximin e saktë nga distanca edhe në intervale të shkurta kohore.

Centralizimi i pëlqimeve energjetikë dhe kërkesave të konsumatorëve të rinj për kyçje në rrjetin e shpërndarjes është një masë që parandalon diskriminimin e këtyre konsumatorëve të cilët kyçen në rrjet në bazë të parimeve të nevojshme teknike dhe procedurave.

OSSH-ja në përputhje me strategjinë e energjisë të vendit ka marrë masat e duhura për mos diskriminimin e gjeneratorëve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Procedurat e OSSH-së bëjnë të mundur që për të gjithë gjeneratorët e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të kyçen në rrjetin e shpërndarësës së energjisë elektrike në bazë të zgjidhjeve teknike që mundësohen nga OSSH-ja duke mos diskriminuar gjeneratorët dhe shfrytëzuesit aktual të sistemit të shpërndarjes.

OSSH-ja ka përgatitur draftin e “Metodologjisë të Taksave për Kyçje” i cili gjendet në diskutim publik. Kjo metodologji është një metodologji gjithëpërfshirëse për të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike dhe parashikohet që me aprovimin e saj nga ZRRE-ja të rritet transparenca, zvogëlohet rreziku i sjelljeve diskriminuuese dhe gjithashtu të jepen sinjale të sigurta ekonomike.

Në vitin 2016 ZRRE-ja ka lëshuar dy (2) licenca të reja për furnizues të energjisë elektrike. Deri tani asnjë konsumator i energjisë elektrike nuk është furnizuar nga këto furnizues të rinj dhe të gjithë konsumatorët fundorë furnizohen me energji elektrike nga FPPE. OSSH-ja ka marrë masat dhe është gati që sistemet informatike të saj ti përgjigjen kërkesave të furnizuesve të rinj në mënyre transparente dhe jo diskriminuuese.



-Informimi i Publikut

OSSH-ja ka informuar vazhdimisht publikun për përshkrimin e sistemit të shpërndarjes, planet zhvillimore, rregullat për operimin e sistemit të shpërndarjes dhe informacione të ndryshme si edhe në lidhje formularët e aplikimeve.. Të gjitha këto informacione përditësohen sa herë që është nevoja dhe të gjitha informacionet në fjalë publikohen në faqen elektronike të OSSH.

-Informatat Konfidenciale

Informacioni i ndjeshëm komercial përkufizohet si çdo informacion, zbulimi i të cilit do të cenonte materialisht interesin e çdo personi dhe subjekti juridik duke penguar dhe prishur konkurrencën. Informacioni i ndjeshëm komercial i referohet çdo informate në lidhje me, punët dhe financat e një përdoruesi të sistemit të shpërndarjes. Kufizimet në transferimin e informacionit behën dhe monitorohen nga sistemet informatike të KEDS-it. Gjithashtu të gjithë punonjësit e OSSH-së obligohen ti përmbahen kushteve të trajtimit dhe mbrojtjes të informacioneve komerciale të parashikuara Legjislacionin ne fuqi, në Kodin e Etikes dhe Punës dhe marrëveshjeve të punësimit.

-Ndërprerja dhe Reduktimi i Furnizimit të Energjisë Elektrike

OSSH-ja ka përgjegjësi të operojë në mënyrë ekonomike rrjetin e shpërndarjes për të arritur qëndrueshmërinë e sistemit, vazhdimësinë e tij dhe furnizimin e sigurtë me energji elektrike. Me qëllimin për të arritur këto objektiva afatgjata OSSH-ja, investon, përforcon dhe mirëmban vazhdimisht rrjetin e shpërndarjes.

Punimet ne rrjetin e shpërndarjes kërkojnë ndërprerje të energjisë elektrike gjatë kohës të realizimit të detyrave.

Ndërprerjet e furnizimit të energjisë elektrike shkaktohen nga tre (3) faktor kryesor, respektivisht mirëmbajtja e planifikuar dhe investimet ne rrjet, defektet në rrjet dhe kërkesat nga palët e treta.



Edhe sepse defektet në rrjet janë pjese e sistemit, kryesisht shkaktohen nga kushtet e këqija atmosferike dhe mbingarkesa në zona periodha të caktuara.

Në lidhje me mirëmbajtjen e planifikuar, OSSH-ja ka parapëlqyer qasjen e mirëmbajtjes parandaluese duke synuar te zvogëloje frekuencën e dështimeve, dhe si rrjedhoje ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike. Plani indikativ i mirëmbajtjes është përgatitur dhe dërguar ne ZRRE. Gjithashtu OSSH-ja ka dërguar ne ZRRE planet mujore te mirëmbajtjes.

Konsumatorët dhe palët e interesuara janë njoftuar për datën dhe kohëzgjatjen e mundshme të ndërprerjeve.

Përfundim

Masave të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese ndaj pjesëmarrëseve të sektorit të energjisë dhe palëve të interesuara dhe masat e mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm në përputhje me Programin e Pajtushmërisë janë të kënaqshme, korniza e themeluar dhe rekomandimet e ZRRE-së janë gjithëpërfshirëse dhe e kanë ndihmuar kompaninë dhe punonjësit e saj të kryejnë operacione dhe aktivitete në mënyrë etike dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative.

Ky Raport i Pajtushmërisë i është paraqitur Bordit Drejtues të KEDS-it.

Zyrtari i Pajtushmërisë

Ermal Koçi

